

KONTRATË SHITBLERJE KUOTE

Kjo Kontratë Shitblerje Kuote ("Kontrata") e lidhur sot më datë 04/01/2024 nga dhe midis:

Marina di Valona SH.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me seli në adresën: Lobby Home, Rruga Nacionale Tiranë- Elbasan, përballë Qendrës Tregtare TEG, Farkë, Lundër, Tiranë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT: M01324008A, , përfaqësuar nga Znj. Eranda Muskaj, në vijim referuar si (referuar në vijim si "Shitësi"),

Dhe

Brunes SH.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në adresën: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7, ZK.2105, Ndërtesa me Nr.Pasurie 187/23 dhe Nr.Pasurie 187/24, Kashar, Tiranë, Shqipëri, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K37125203H, përfaqësuar nga Z. Geront Çela, i cili vepron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë (në vijim referuar si "Blerësi").

Shitësi dhe Blerësi do të referohen së bashku si "Palët" dhe individualisht si "Pala".

PREAMBULA

(A) **Shoqëria Koncesionare Marina Vlorë SH.P.K.**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me seli në adresën: Lobby Home, Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Farkë, Lundër, Tiranë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT: M12027029I, me kapital të regjistruar 542,001,000.00 (pesëqind e dyzet e dy milion e një mijë) Lek, në vijim referuar si "Shoqëria".

(B) Në datën e kësaj Kontrate, Shitësi zotëron 99.9999% (nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë që konsiston në vlerën në para prej 542,000,500.00 (pesëqind e dyzet e dy milion e pesëqind) lekë.

(C) Në datën e kësaj Kontrate, Blerësi zotëron 0.0001% të kapitalit të Shoqërisë që konsiston në vlerën në para prej 500 (pesëqind) Lek.

(D) Shitësi ka rënë dakord t'i shesë Blerësit 87.9999% (tetëdhjetë e shtatë pikë nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë përqind) të kapitalit të Shoqërisë që konsiston në një kuotë (në vijim referuar si "Kuota"), në vlerën 476,960,338.00 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tetë) Lek ose 4,165,026.00 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëzet e gjashtë) EUR së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me to dhe Blerësi ka rënë dakord të blejë Kuotën nga Shitësi, në përputhje me kushtet dhe subjekt i kushteve të kësaj Kontrate.

(E) Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Blerësi dëshiron të blejë dhe Shitësi dëshiron të shesë dhe transferojë te Blerësi, Kuotën.

PËR KËTË ARSYE, është rënë dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET / INTERPRETIMI

Titujt e të gjitha dispozitave këtu janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndryshojnë, zgjerohen ose kufizojnë asnjë nga dispozitat e saj.

2. QËLLIMI I KONTRATËS

Në varësi të kushteve të kësaj Kontrate, Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi, Kuotën me garanci të plotë dhe të çliruar nga çdo barrë, bashkë me të drejtat dhe detyrimet që lidhen me to.

3. ÇMIMI I BLERJES SË KUOTËS

3.1 Çmimi total i blerjes për Kuotën është 476,960,338 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tetë) Lek ose 4,165,026 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëzet e gjashtë) EUR, ("Çmimi i Blerjes").

3.2 Palët kanë rënë dakord se pagesa e Çmimit të Blerjes do të kryhet me transfertë bankare në llogarinë bankare të Shitësit me të dhënat e mëposhtme:

Banka: Tirana Bank
Monedha: EUR
Nr. Llogarie: 0110-321349-101
IBAN: AL25206110110000110321349101
SWIFT: TIRBALTR

3.3 Çmimi i Blerjes do të paguhet i plotë dhe pa ndalesa të çfarëdoqësi qofshin në llogarinë e Shitësit, brenda 3 ditëve pune nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga të dy Palët.

3.4 Nëse Çmimi i Blerjes nuk paguhet i plotë, në mënyrën dhe brenda afateve të përcaktuara këtu më lart, kjo Kontratë do të konsiderohet e pavlefshme.

4. TRANSFERIMI I KUOTËS

4.1 Titulli i pronësisë së Kuotës i transferohet i plotë Blerësit në ditën e kryerjes së pagesës së Çmimit të Blerjes nga Blerësi.

4.2 Transferimi i Kuotës do të kryhet në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

4.3 Të drejtat mbi Kuotën do të transferohen tek Blerësi në datën kryerjes së rregullt të pagesës së Çmimit të Blerjes, nga Blerësi tek Shitësi dhe Kuota do të shitet dhe blihet së bashku me të gjitha të drejtat dhe përfitimet që lidhen me to.

5. DEKLARIME DHE ANGAZHIME

5.1 Palët deklarojnë se kanë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej saj.

5.2 Shitësi dhe Blerësi autorizojnë Administratorin e Shoqërisë për regjistrimin e transferimit të Kuotës në Regjistrin Tregtar nën emrin dhe pronësinë e Blerësit duke depozituar, ai vetë apo duke emëruar një përfaqësues të autorizuar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB") këtë Kontratë si dhe çdo dokument tjetër që mund të jetë i nevojshëm për qëllimin e një regjistrimi të tillë.

6. LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Ky Akt dhe marrëdhënia mes Palëve do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

7. JURIDIKSIONI

Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga ose lidhet me këtë Kontratë ose ka të bëjë me zbatimin ose vlefshmërinë e saj do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

8. TË NDRYSHME

8.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë të ndryshohet vetëm me shkrim dhe këto ndryshime të nënshkruhen nga Palët ose nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

8.2 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet, tërësisht ose pjesërisht, e pavlefshme,

joefektive, ose e pazbatueshme, vlefshmëria, efektet dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të Kontratës nuk do të preken. Çdo dispozitë e tillë e pavlefshme, joefektive ose e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme, që i afrohet qëllimit ekonomik të dispozitës së pavlefshme, joefektive ose të pazbatueshme në lidhje me lëndën, shtrirjen, kohën, vendin dhe fushëveprimin e dispozitës përkatëse. Sa më sipër do të zbatohet mutatis mutandis për çdo boshllëk që mund të gjendet se ekziston në këtë Kontratë.

9. GJUHA DHE KOPJET

Kjo Kontratë nënshkruhet në 2 (dy) njësi origjinale në gjuhën shqipe, me vlefshmëri ligjore të njëjtë.

Nënshkruar më 04/01/2024

SHITËSI

Eranda Muska


Emri: Eranda Muska

Titulli: Administrator

Në emër të: **Marina di Valona SH.P.K**



BLERËSI



Emri: Geront Çela

Titulli: Administrator

Në emër të: **Brunes SH.P.K.**

